



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

Adresa: Fushë-Arrëz, Prefektura Shkoder, Tel: 027123131, email: [bashkiafushearrez@hotmail.com](mailto:bashkiafushearrez@hotmail.com)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Fushë-Arrëz, me 08.03.2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: Operatorin Ekonomik **"DIEZELA" sh.p.k**, me seli Rruga "Ali Demi", Shkoze, perball News 24, Tirane.

Procedura e prokurimit: **Kerkese per Propozim.**

Numri i referencës së procedurës: **REF-85710-02-03-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti i prokurimit: **"Blerje karburanti për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2021"** me fond limit: **5,056,666** (pesë milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, vene ne dispozicion nga Grand + te ardhura te Bashkise, afati i kontrates 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi me marsh fitimi me te ulet.**

**Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. Operatori Ekonomik **"DIEZELA" sh.p.k**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**K91420010C**

*numri i NIPT-it*

**5,056,666** (pesë milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH., si dhe me oferte totale me marsh fitimi ne total **25%** (njetzet e pese perqind) per liter.

1. Operatori Ekonomik **"KASTRATI" sh.p.k**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**J61813529P**

*numri i NIPT-it*

**5,056,666** (pesë milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH., si dhe **me oferte totale me marzh fitimi ne total 15.4%** (pesëmbëdhjetë pike kater perqind) per liter.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik, **"KASTRATI" sh.p.k**, me numer identifikues NIUS, **J61813529P**, ka mangesi, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe **konkrektisht:**

**1. Mungojne dokumentet qe vertetojne se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksat e tarifat vendore,** lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitet për vitin 2020, kërkuar në DST, pika 2.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", paragrafi 2.2.2, konkretisht mungojne vertetimet për disa nga adresat e shitjes në pikat e Durrësit, Vertetimi i Bashkisë Mat etj. Po ashtu keni paraqitur listen e distributoreve të shitjes së naftës me pakicë ku specifikohet edhe adresa e Fushe-Arrezit, numri rendor 88 i listës (Kel Gjini), por nga verifikimet në ekstraktin e QKB-se, nuk rezultojn asnjë pikë shitje në Bashkinë Fushe-Arrez.

**2. Mungon dokumenti qe verteton shlyerjen e te gjitha detyrimeve te energjise elektrike,** kërkuar në DST, pika 2 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", shkronja d, pasi Vertetimi i paraqitur i Debisë nga FSHU nr.638 prot., datë 22.01.2021, citon se ka 0 (zero) detyrime të energjisë elektrike (sipas listës bashkelidhur), listë e cila mungon bashkelidhur vertetimit të paraqitur në sistem, e për pasojë dokumenti është i pasakte.

- Për mangësitë e konstatuar **"KASTRATI" sh.p.k**, Skualifikohet pasi nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Janë kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori Ekonomik, **"DIEZELA" sh.p.k**, me numer identifikues NIUS, **K91420010C**, i ploteson të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, e për pasojë **kualifikohet**.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **"DIEZELA" sh.p.k**, me adresë Tiranë. Se oferta e paraqitur, **me oferte totale 5,056,666** (pesë milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, si dhe **me marzh fitimi ne total 25%** (njetzet e pese perqind) per liter, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkisë Fushe-Arrez* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.02.2021

Ankesa: **SKA**

**K R Y E T A R I**

**Fran TUCI**